

V E N D I M
Nr.30, datë 23.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Zija Vuci,	Anëtar i““
Bardha Selenica,	Anëtare e““
Kristofor Peçi,	Anëtar i““
Kujtim Puto,	Anëtar i““
Sokol Sadushi,	Anëtar i““
Hilmi Dakli,	Anëtar i““

më datë 22.2.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.14 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: AGIM ÇIRAKU, i përfaqësuar nga avokat Agron Lamaj.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. ISKRA TATA (THOMA), e përfaqësuar nga avokat Kirov Babliku.

2. PAULIN KOKA, në mungesë.

3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TE PRONAVE RAJONI NR.2, pranë Bashkisë Tiranë, në mungesë.

O B J E K T I:

Shpallja antikushtetuese e vendimeve nr.9966, datë 17.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.1719, datë 8.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.190, datë 18.2.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, dhënë në Dhomën e Këshillimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesve të palës kërkuese, të subjektit të interesuar Iskra Tata (Thoma) dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata Kushtetuese, pa i hyrë në themel kërkesës, konstaton se me Ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, që ka hyrë në fuqi që më 26 janar 1999, në nenin 5 të tij që ndryshon nenin 473 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: “Kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit si dhe vendimeve të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë që për shkaqet e parashikuara në gërmat “a”, “b” dhe “c” të nenit 472 të atij Kodi, të bëjnë rekurs në Kolegjet e Bashkuara brenda 3 vjetëve nga marrja formë të prerë të vendimit”.

Kështu, palës së interesuar i krijohet edhe një rrugë e zakonshme rekursi. Në mbështetje të kësaj dispozite Gjykata Kushtetuese, (që në bazë të nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vendos gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave) nuk mund ta marrë në shqyrtim kërkesën derisa të mos jetë ndjekur edhe kjo rrugë tjetër e zakonshme e krijuar me ligjin e sipërpërmendur.

Duke qenë se kërkesa i referohet pikërisht shkaqeve të parashikuara në gërmat “a”, “b” e “c” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile,

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 132 të Kushtetutës dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni kushtetues.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 23.3.1999

Nr. 14 i regjistrimit themeltar

Nr. 30 i vendimit.